



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

## **Raport i Vlerësimit vjetor për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë** **Viti akademik 2015-2016**

Albanian University është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, i cili është licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Ky institucion në vitin 2016, shënon vitin e 12 që ofron programe studimi universitare, të ciklit të parë dhe të integruar dhe që nga viti akademik 2008 – 2009 ofron programe studimi të ciklit të dytë dhe më vonë të ciklit të tretë, si: specializimet dhe programet e doktoraturës.

Raporti i vlerësimit të brendshëm institucional për vitin akademik 2015-2016 shqyrton veprimtarinë e aktorëve kryesorë të AU duke u fokusuar në misionin dhe objektivat, stafin akademik, kurrikulën, politikat e formimit të studentëve, politikat e kërkimit shkencor, zhvillimin e karrierës, strategjitë e zhvillimit, etj. Raporti përmbledh përshkrimet analitike të situatës, treguesit e matshëm, dhe vlerësimin sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të brendshëm, përfundimet e arritura, si dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ngritjen e strukturave dhe nivelit të kërkimit shkencor në vitet e ardhshme.

### **VIZIONI, MISIONI DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK I AU**

**Vizioni** i “AU” është që të shndërrohet në një institucion arsimor i nivelit të lartë, i njohur për kompetencën e të diplomuarve të saj, për programet e saj të forta dhe orientimin ndërdisiplinor. Synimi i këtij institucioni është ndikimi në shoqëri përmes iniciativave arsimore, kërkimore shkencore, ekonomike, intelektuale dhe kulturore.

“AU” pretendon të zhvillojë një proces mësimor e kërkimor emocionues dhe sfidues, me infrastrukturë të arrirë: bibliotekë cilësore, laboratorë të mjaftueshëm, teknologji bashkëkohore, mjedise të sigurta e të bukura.

“AU” punon që të arrijë standardet e kërkua përmes vetëvlerësimit të vazhdueshëm e rigoroz duke e matur suksesin me treguesit e besueshëm të përfitimeve për studentët në aspektin etik, shkencor e profesional që do të garantojë përgatitjen e tyre si qytetarë të denjë e me besim në drejtim të suksesit ekonomik dhe të një jete cilësore.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

“AU” ka si objektiv gjithashtu që pjesëtarët e komunitetit të saj të gjejnë në këtë institucion stimulim e nevojshëm intelektual dhe kulturor, duke qenë nga të gjitha krahinat e vendit e më gjerë, nga të gjitha kategoritë shoqërore dhe moshore, por të angazhuar në botën e ideve.

**Misioni** i “Albanian University” është të sigurojë arsimim cilësor universitar dhe pasuniversitar dhe të ofrojë përgatitje profesionale të rendit të parë në edukim, në shkencat mjekësore, në shkencat e aplikuara inxhinierike dhe ekonomike, në shkenca sociale dhe juridike, në mësuesi dhe administrim publik, etj.

“Albanian University” ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve për një spektër të gjerë njohurish, të domosdoshme për zhvillimin e karrierës së ardhme, dhe që krijon mundësi për nxitjen e pasionit për rinovim njohurish përmes të mësuarit gjatë gjithë jetës. Studentët në këtë institucion përgatiten për një botë në ndryshim, si kontribuues përmes dijeve dhe përmes shërbimit. Duke ndjekur zhvillimet arsimore, shkencore, ekonomike e shoqërore në vend dhe jashtë tij, “AU” është i angazhuar për respektimin dhe ruajtjen e vlerave që lidhen me diversitetin e elementëve etnik, social dhe kurrikular duke pasqyruar një vetëdije globale. Kështu, “AU” mbetet i hapur për të rekrutuar studentë të kategorive të ndryshme shoqërore dhe nacionale duke bërë kujdes që të mbetet i angazhuar për të përsosur procesin mësimor, kërkimin shkencor, edukimin qytetar e kulturor, në funksion të ofrimit të një shërbimi publik për të gjithë, në një shoqëri të hapur.

“AU” beson në përgatitjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të studentëve, si kolona të nevojshme për të shërbyer në shoqëri si qytetarë të shkolluar dhe të kualifikuar. Duke vlerësuar e zbatuar eksperiencën të traditës për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, “AU” mbështet dhe nxit rrugë e metoda të reja për zhvillimin profesional e kulturor të studentëve. Për këtë qëllim, krijohen mundësi të shumta edhe në bashkëpunim me Këshillin Studentor për praktika mësimore, programe kulturore dhe artistike, si dhe për pjesëmarrje në veprimtari çlodhëse e të dobishme për publikun dhe në shërbim të komunitetit.

Të udhëhequr nga vlerat dhe të përqendruar te njerëzit, ky institucion synon të përdorë njohuritë që transmeton tek studentët për të ndryshuar të ardhmen e jetës së tyre, duke kontribuar kështu për një shoqëri produktive dhe të begatë.

Për përmbushjen e misionit të tij, institucioni ofron një ofertë akademike elastike dhe të mbështetur nga epërsia në mësimdhënie dhe mësim nxënie, duke krijuar një pjesëmarrje aktive të studentëve, kërkim shkencor të zbatuar me njohje dhe ndikim brenda vendit, bashkëpunim me biznesin dhe sipërmarrjet, duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë.

“Albanian University” ka një strategji afatshkurtër dhe një strategji afatgjatë për përmbushjen e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e tij. Prandaj dhe pretendon të



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

jetë një institucion i përparuar i arsimit të lartë. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e orientimeve kryesore me rëndësi për sukses në të ardhmen. Këto drejtime strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë objektivash të ndërlidhura.

“Albanian University” përfaqëson një nga alternativat serioze, të besueshme, profesionale dhe konkurruese në rrjedhën e zhvillimeve të shumta të Arsimit të Lartë që synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me tregun e punës.

“Albanian University” është i orientuar drejt vlerave dhe formave të reja të kërkim-zhvillimit, duke synuar të formojë specialist të zot që marrin përsipër e u përgjigjen me dinjitet sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur.

Misioni i Albanian University është zhvillimi dhe zgjerimi i kufijve të njohjes përmes arsimit më të mirë, rritjes intelektuale, sociale e kulturore të studentëve, duke kontribuar në dobi të komunitetit me aspiratën e një mjedisi intelektual që nxit mendimin kritik, krijues, me vlera, parime dhe etikë akademike institucionale. Si një universitet privat por me një mision të rëndësishëm publik, Albanian University stimulon studentët në zhvillimin e hulumtimeve dhe reflektimeve për çështjet e rëndësishme të komunitetit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, nëpërmjet një arsimit cilësor dhe programeve moderne të studimit.

Në vazhdim të misionit tonë qëndron ridimensionimi i arsimit universitar, rritja e programeve kërkimore, nxitja e klimës së respektit të ndërsjellët tek studentët, mbështetje në zhvillimin e ideve të tyre në shërbim të kombit dhe të shtetit, me qëllimin primar përsosmërinë e universitetit dhe bërjen e tij kompetitiv në tregun e punës. Misioni është nxjerrja e një produkti sa më kompatibil me tregun, në arritjen e targetit themelor: “Produktit që përparon në tregun e punës, profesionistit”! Në hierarkinë e vlerave të Albanian University, qëndron dimensionin human dhe vullnetarizmi, që përkthehet në përparësinë e vullnetit mbi intelektin dhe veprimin në mendimin intelektual, nëpërmjet një aktiviteti të përbashkët dhe punë të frytshme vullnetare që nxit të mirën e përgjithshme. Albanian University si vlerë, por edhe materialisht, u përket studentëve, pedagogëve, punonjësve dhe të gjithë atyre që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nisme. Objektivat tona janë ambicioze e afatgjata, e bazuar në akreditimin e programeve dhe Statutin e Albanian University, synojmë të sigurojmë rritje cilësore në përgatitjen e brezave për t’ju përgjigjur ekonomisë së tregut, duke synuar të jemi gjithmonë një qendër e fuqishme e arsimit jo publik në vend.

**Vlerat tek të cilat besojmë:**

- Cilësia në çdo iniciativë akademike;
- Integriteti dhe korrektësia organizative;



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

- Kolegjialiteti dhe pjesëmarrja në vendimmarrje;
- Vullnetarizmi dhe përgjegjshmëria në arritjen e standardeve arsimore;
- Përgjegjshmëri dhe liri akademike;
- Ruajtja e etikës dhe krijimi i besueshmërisë.

“Albanian University” ka si kolona të forta për besim dhe sukses orientimin drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, profesionalizmin e përkushtimin e shkallës së lartë, bashkëpunimin dhe partneritetin e vazhdueshëm e të pandërprerë me studentët dhe faktorët e tjerë që motivojnë dhe nxisin progres.

“Albanian University” krijon mundësi të mëdha për arritjen e potencialeve të plota fizike, intelektuale, emocionale, sociale dhe shpirtërore që nevojiten në një botë pa kufij.

### **Përparësi të institucionit “Albanian University”**

Disa nga përparësitë e “AU” janë:

- Numri i madh i Programeve të Studimit që ofron në ciklin e parë (Bachelor), tërësisht për profesione të kërkuara e me shumë mundësi punësimi;
- Standardet e larta akademike të evidentuara me përqindjen e lartë të stafit me tituj e grada shkencore;
- Besueshmëria publike e institucionale e lartë;
- Pajtueshmëria në rritje me kurrikulat e programet e përparuar në vend, në rajon e më gjerë;
- Treguesit infrastrukturorë e laboratorikë sipas standardeve të kërkuara;

#### **1. Programet e studimit**

- Programet e studimit të zhvilluara gjatë vitit dhe ecuria e tyre,
- Programet aktivë dhe jo aktivë,
- Programet që janë akredituar gjatë vitit ose jo, ato që duhet të ri/akreditohen në vitin e ardhshëm.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 janë akredituar 13 programe studimi, nga 35 për të cilat është aplikuar vitin e kaluar. Konkretisht:

- Bsc. “Menaxhim Biznesi”
- Bsc. “Dizajn”
- Bsc. “Anglisht”
- Bsc. “Inxhinieri Mekatronike”



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

- Bsc. “Mësuesi për Arsimin Fillor”
- Bsc. “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”
- Bsc. “Fizioterapi”
- Bsc. “Infermieri”
- Mp. “Menaxhim Bankar dhe Financiar”
- Mp. “Administrim Biznesi”
- Mp. “Infermieri Kirurgjikale”
- Msc. “Teknologji Informacioni”
- Msc. “Inxhinieri Elektronike”

Gjithashtu, këtë vit akademik është aplikuar për akreditimin e 11 programeve të studimit, (4 Bsc, 3 programe të integruara studimesh, 3 Msc. dhe 1 specializim) prej të cilave 7 programe (4 Bsc + 3 të integruara) e kanë kaluar akreditimin e parë në vitin 2010 dhe tani janë në proces riakreditimi.

\*Për më shumë informacion shiko tabelën e mëposhtme!

Në përfundim të këtij viti akademik, AU synon të akreditojë të gjitha programet e studimit që ofron dhe gjithashtu të fitojë akreditimin institucional.

Tabela 1

FAKULTETI	DEPARTAMENTI	PROGRAMI I STUDIMIT	AKTIV/ JO AKTIV (2015-2016)	STATUSI I AKREDITIMIT
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE</b>	DEPARTAMENTI I STOMATOLOGJISË	Msc. Stomatologji	Aktiv	Urdhër nr. 388, dt. 1.12.2010 (Në proces Riakreditimi)
		Spa. Kirurgji	Aktiv	Në proces Akreditimi
		Spa.Kirurgji OMF	Aktiv	Në proces Akreditimi
		Spa. Ortodonci	Aktiv	Në proces Akreditimi
		Spa.Implantologji	Aktiv	Në proces Akreditimi
		Spa.Endodonti	Jo aktiv	Pa akredituar
		Spa.Dentistri Pediatrike	Jo aktiv	Pa akredituar



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

		Spa.Prosthodonti	Jo aktiv	Pa akredituar	
		Spa. Periodontologji	Jo aktiv	Pa akredituar	
	DEPARTAMENTI I FARMACISË	Msc. Farmaci	Aktiv	Urdhër nr. 462, dt. 14.10.2010 (Në proces Riakreditimi )	
		Dr. Shkenca Farmaceutike	Aktiv	Në proces Akreditimi	
	DEPARTAMENTI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË	Bsc. Infermieri	Aktiv	Urdhër Nr. 239, datë 09.05.2016	
		Bsc. Fizioterapi	Aktiv	Urdhër Nr. 238, datë 09.05.2016	
		Mp. Infermieri Kirurgjikale	Aktiv	Urdhër Nr. 242, datë 09.05.2016	
	FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE	DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS	Msc. Arkitekturë	Aktiv	Urdhër nr. 445, dt. 1.10.2010 (Në proces Riakreditimi)
			Bsc. Design	Aktiv	Urdhër nr. 439, dt. 25.08.2016
			Dr. Arkitekturë	Jo aktiv	-
DEPARTAMENTI I INXHINIERIVE		Bsc. Teknologji Informacioni	Aktiv	Në proces Akreditimi	
		Bsc. Inxhinieri Elektrike	Aktiv	Në proces Akreditimi	
		Bsc. Inxhinieri Elektronike	Aktiv	Në proces Akreditimi	
		Bsc. Inxhinieri Mekatronike	Aktiv	Urdhër nr. 436, dt. 25.08.2016	
		Bsc. Inxhinieri Kompjuterike	Aktiv	Në proces Akreditimi	



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

		Msc. Teknologji Informacioni	Aktiv	Urdhër nr. 383, dt. 8.07.2016
		Msc. Inxhinieri Elektronike	Aktiv	Urdhër nr. 380, dt. 8.07.2016
		Msc. Inxhinieri Mekatronike	Aktiv	Në proces akreditimi
		Msc. Inxhinieri Kompjuterike	Aktiv	Në proces akreditimi
	<b>DEPARTAMENTI I SHKENCAVE EKONOMIKE</b>	Bsc. Financë - Bankë	Aktiv	Urdhër nr. 541, dt. 1.12.2010 (Në proces Riakreditimi)
		Bsc. Menaxhim Biznesi	Aktiv	Urdhër Nr. 240, datë 09.05.2016
		Mp. Menaxhim Bankar dhe Financiar	Aktiv	Urdhër Nr. 441, datë 25.08.2016
		Mp. Administrim Biznesi	Aktiv	Urdhër Nr. 440, datë 25.08.2016
		Mp. Menaxhim shëndetësor	Jo aktiv	-
		Msc. Menaxhim Bankar	Aktiv	Urdhër nr. 327, dt. 7.08.2012
	Msc. Administrim Biznesi	Aktiv	Urdhër nr. 327, dt. 7.08.2012	
	Dr. Financë	Jo aktiv	-	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE</b>	<b>DEPARTAMENTI I SHKENCAVE JURIDIKE</b>	Bsc. Shkenca Juridike	Aktiv	Urdhër nr. 541, dt. 1.12.2010 (Në proces Riakreditimi)
		Mp. Shkenca Penale	Aktiv	Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012
		Mp. E Drejtë Private	Aktiv	Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

	Msc. Shkenca Juridike (5 profile)	Aktiv ( 3 profile)	Në proces Akreditimi
	Dr. E Drejtë dhe Procedurë Penale	Jo aktiv	-
	Dr. E Drejtë Evropiane e Kontratave	Aktiv	Në proces Akreditimi
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË SË PËRGJITHSHME	Bsc. Psikologji e Përgjithshme	Aktiv	Urdhër nr. 541, dt. 1.12.2010 (Në proces Riakreditimi)
	Mp. Psikologji Shkollore	Aktiv	Në proces Akreditimi
	Mp. Psikologji Klinike	Aktiv	Urdhër nr. 327, dt. 07.08. 2012
	Msc. Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore	Aktiv	Në proces Akreditimi
	Msc. Psikologji Klinike	Aktiv	Urdhër Nr. 327, datë 07.08.2012
	Msc. Psikologji Ligjore	Aktiv	Në proces Akreditimi
	Msc. Këshillim Psikologjik	Aktiv	Në proces Akreditimi
	Dr. Psikologji Klinike	Aktiv	Në proces Akreditimi
	DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO – ADMINISTRATIVE	Bsc. Shkenca Politiko-Administrative	Aktiv
Mp. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci		Jo Aktiv	Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012





**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

		Mp. Qeverisje dhe Administrim Publik	Aktiv	Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012
		Mp. Studime mbi Sigurinë	Jo aktiv	Në proces Akreditimi
		Msc. Marrëdhënie Ndërkombëtare (me 2 profile)	Jo aktiv	Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012
		Msc. Administrim Publik (me 2 profile)	Aktiv	Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012
		Dr. Marrëdhënie Ndërkombëtare	Jo aktiv	-
		Dr. Shkenca Administrative	Aktiv	Në proces Akreditimi
	DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE ANGLISHTES	Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor	Aktiv	Urdhër nr. 381, dt. 8.07.2016
		Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor	Aktiv	Urdhër Nr. 241, datë 09.05.2016
		Bsc. Anglisht	Aktiv	Urdhër nr. 437, dt. 25.08.2016
		Mp. Pedagogji me profil "Didaktikë"	Aktiv	Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013
		Mp. Pedagogji me profil "Menaxhim Arsimit"	Aktiv	Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013
		Msc. Mësuesi për Arsimin Fillor	Aktiv	Në proces akreditimi

## 2. Staf i Pedagogjik

- Staf i akademik, statistika, cilësia e stafit, puna e pedagogëve e matur përmes vëzhgimeve, përpunimit të pyetësorëve.



ALBANIAN UNIVERSITY  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

- Përmbledhje e çështjeve shqetësuese që kanë paraqitur studentët në përgjigjet e tyre në një tabelë.

Albanian University në vitin akademik 2015-2016 ka pasur një staf akademik të përbërë prej 545 pedagogësh prej të cilëve, 204 janë të angazhuar me kohë të plotë dhe 341 me kohë të pjesshme. Në krahasim me vitin akademik 2014-2015, (432 me pedagogë të angazhuar prej të cilëve 171 efektiv) shohim një rritje me 11.3% të numrit të përgjithshëm të pedagogëve. Konkretisht, në vitin 2015-2016, në *Fakultetin e Shkencave Mjekësore* janë angazhuar me kohë të plotë 22 pedagogë me tituj e me grada (1 Profesor Doktor, 1 Profesor i Asociuar dhe 20 Doktorë Shkencash) nga 152 në total që përbëjnë personelin akademik efektiv në këtë fakultet.

*Në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike*, në vitin 2015-2016 janë angazhuar 14 pedagogë efektiv me tituj e me grada (3 Profesorë Doktorë, 2 Profesorë të Asociuar dhe 9 Doktorë Shkencash) nga 85 që është totali i përgjithshëm i personelit akademik efektiv në këtë fakultet.

*Në Fakultetin e Shkencave Shoqërore*, janë angazhuar 22 pedagogë me grada e tituj shkencorë (2 Profesorë Doktorë, 4 Profesorë të Asociuar dhe 15 Doktorë Shkencash) nga 104 totali.

Në vitin 2016-2017 AU synon rritjen e PAE me tituj dhe grada në masën mbi 70%.

Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programet e studimit dhe të personave përgjegjës për organizimin e programeve të ndryshme të studimit. Po kështu, institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.

Për realizimin e programeve të studimit aktivizohen edhe pedagogë nga departamente të tjera si dhe pedagogë të jashtëm nga Universiteti i Tiranës dhe institucione të tjera që lidhen me arsimin dhe edukimin. Rreth 70% e ngarkesës mësimore të planifikuar për programet e studimit të ofruara nga institucioni ynë pothuajse zhvillohet nga pedagogët e punësuar me kohë të plotë.

Shihet se institucioni ka angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore. Për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, institucioni ka aktivizuar në çdo praktikë së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë.

Pedagogët e jashtëm të AU punojnë në qendra që bëjnë kërkime shkencore. Kështu, ata përpiqen të lidhin punën e tyre kërkimore me teorinë që promovojnë te studentët. Studentëve u kërkohet që së bashku me pedagogët të realizojnë punime që kërkojnë përfshirjen e gjerë të tyre në përgatitjen e pyetësorëve, anketimeve, përdorimit të statistikave, interpretimin e tyre. Studentët mësojnë të vëzhgojnë, të bëjnë investigime, të dalin në konkluzione dhe të prezantojnë gjetjet e tyre gjatë



ALBANIAN UNIVERSITY  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

gjithë semestrave. Një vend të konsiderueshëm zënë edhe analizat e punës drejtuese dhe administrative në traditën tonë dhe krahasimin me praktikën e huaja.

Për kualifikimin e mëtejshëm të punonjësve të tij, institucioni edhe këtë vit ka organizuar programe specifike që kanë të bëjnë me informacionet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizim konferencash në institucion etj.

Nga vëzhgimet dhe verifikimet e bëra këtë vit akademik vërehet se puna e stafit nuk fokusohet vetëm në lëndët dhe orët mësimore: pjesa më e madhe e tyre mbulon disa lëndë, por që nuk kalojnë numrin dy brenda një semestri. Prania e tyre në shkollë kapërcen orët mësimore (leksione apo seminare): studentët kanë mundësi të komunikojnë me stafin mësimor në konsulta dhe takime të ndryshme. Stafi ka zhvilluar takime të rregullta brenda departamentit si për vetë kualifikimin e tij, ashtu dhe për marrjen e vendimeve të rëndësishme që lidhen me mësimdhënien, studentët dhe probleme të tjera.

Institucioni ka organizuar gjatë vitit akademik 2015- 2016 disa ditë apo javë informimi kur janë shpërndarë broshura informuese si udhëzues programesh, plan programe dhe materiale të tjera që ndërgjegjësojnë publikun për vlerat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në AU.

Institucioni gjithashtu ka zhvilluar mjaft veprimtari me karakter integruar social për personelin akademik dhe ndihmës shkencor.

Kështu, gjatë këtij viti akademik AU ka organizuar disa programe kualifikimi dhe zhvillimi profesional për personelin akademik të drejtuar nga Rektori dhe Zv/rektorët për kërkimin shkencor dhe studimet në fushën e mësimdhënies. Programet kanë pasur si objekt aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për zhvillimin e kurrikulave bashkëkohore, për specifikat e mësimdhënies me studentët, për njohjen me prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë sipas procesit të Bolonjës, për bashkëpunimin me qendrat e zhvillimit të kërkimeve, për këshillimin e karrierës, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të arsimit të lartë, procesin e akreditimit, etj.

ZSBC vëren një përpjekje serioze dhe cilësore për të ndërtuar një sistem të përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, por edhe atij ndihmës kërkimor shkencor mbi bazën e korrektësisë, transparencës, meritokracisë dhe cilësisë së zhvillimit të programit të studimit. AU përdor metodologji vlerësimi për të gjithë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore që janë pjesë e punës së përgjithshme të institucionit. Po ashtu ka investuar për trajnimin e stafit të tij pedagogjik dhe ndihmës në fushën e dijes dhe rritjes së aftësive profesionale.

Puna e pedagogëve për vitin 2015-2016 ka qenë pozitive. Impenjimi i tyre ka qenë maksimal dhe me përgjegjësi, çka reflektohet edhe tek rezultatet e studentëve, por edhe tek përgjigjet e



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

anketimeve të realizuara enkas për këtë qëllim. Si çdo vit akademik, dhe këtë vit në fund të çdo semestri janë zhvilluar anketimet e studentëve në formë elektronike, konkretisht përpara sezonit të provimeve, në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive. Kjo procedurë që tashmë po kthehet në një traditë në AU, i mundëson të gjithë stafit akademik dhe administrativ të reflektojnë mbi punën e realizuar gjatë gjithë vitit, e parë në këndvështrimin e studentëve. Pavarësisht faktit se pothuajse të gjithë të anketuarit shprehen se gjenden shumë mirë në Albanian University dhe do t'ia sugjeronin atë dikujt tjetër, ata kanë shprehur edhe disa pakënaqësi të cilat janë të listuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2

Nr.	SHQETËSIME DHE ANKESA TË STUDENTEVE
1	Pa siguri për njohjen e diplomës nga vendet Evropiane dhe SHBA
2	Hapësirë e vogël në sallat e studimit
3	Biblioteka ka pak tituj në gjuhën shqipe, kërkohet pasurimi i saj
4	Penalizimi i studentëve për shkak të mungesave
5	Mungesë Vend Parkimi

### 3. Infrastruktura

- Mjediset ku zhvillohen leksionet, praktikat, salla e kompjuterëve, laboratorët, etj.
- Biblioteka – tekstet që mungojnë dhe duhen porositur.

Cilat janë nevojat për vitin e ri akademik?

Albanian University disponon mjedise bashkëkohore për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike, në të gjitha godinat ku zhvillojnë mësimin studentët e 3 Fakulteteve.

Infrastruktura e universitetit është moderne: ajo përmban klasa me hapësira të mëdha, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Universiteti ka salla konferencash, të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, flipcharte, etj.

Klasat kanë rafte dhe tryeza pune komode, të vendosura në formë rrethi, auditorësh për të lehtësuar si punën në grupe të mëdha, ashtu dhe atë në grupe të vogla.

Videokasetat dhe CD janë pjesë e zhvillimit të orëve të ndryshme mësimore; pedagogët përdorin filma dhe dokumentarë si pikënisje të debateve dhe diskutimeve për një temë mësimore.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programeve të ndryshme të studimit tekste mësimore të hartuara edhe nga pedagogë të tij. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara zënë një vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përpjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore.

Praktika mbizotëruese mësimdhënëse në “Albanian University” është ajo që për secilën lëndë apo njësi lëndore, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë dhe për literaturën e rekomanduar. Literatura bazë është kryesisht ajo që përdoret edhe në Universitete të tjera publike e private në gjuhën shqipe. Një pjesë e teksteve bazë janë botime të “AU- Press”.

Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Në çdo rast, pedagogu u ofron studentëve leksionet e tij të shkruara. Literatura ndihmëse është gjithashtu e parashikuar dhe e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde dhe njësie lëndore. Është krijuar edhe fondi e-book.

Gjithashtu, universiteti vë në dispozicion të studentëve 3 biblioteka, nga 1 në secilin Fakultet, të cilat përmbajnë literaturë të fushave dhe disiplinave të ndryshme. Në funksion të studentëve është edhe biblioteka online QUESTIA, si dhe ELSEVIER (veçanërisht për studentët e Fakultetit të Mjekësisë). Biblioteka punon me orar 8.00- 16.00, dhe në raste të veçanta, si p.sh. në sesionet e provimeve është e hapur edhe me orar më të zgjatur. Biblioteka pasurohet vazhdimisht me literaturë bashkëkohore. Kështu, nga 2.241 tituj tekstesh të cilat ishin në shërbim të studentëve për vitin që kaloi, për vitin 2016-2017 kemi një pasurim të bibliotekës me 142 tituj tekstesh dhe njëkohësisht jemi në pritje të ardhjes së teksteve të tjera të cilat janë porositur.

*\*Për detaje shiko tabelën e mëposhtme!*

Tabela 3

FAKULTETI	SIP. (m <sup>2</sup> )	SALLA LEKSIONE	SALLA SEMINARE	SALLA KOMPJUTERAVE	SALLA LABORATORI	BIBLIOTEKË
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b> (Godina ish - Gjykatës + ish - Hotel Internacionali + godina e Raiffeisen )	2267.4 + 1834.69 + 452.4= <b>4.554.49</b>	6	9	1	24	1 sallë - 40 vënde  1126 tituj librash + ELSEVIER + QUESTIA



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

<b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</b> (Dep. i Arkitekturës & Dep. i Inxhinierive - Godina Rr. Kavajës)	<b>1901.69</b>	6	7	1	8	1 sallë - 35 vënde 815 tituj librash + 28 tituj të rinj + QUESTIA
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore + Dep. i Shkencave Ekonomike</b> (Godina ish-Estrada)	<b>3996</b>	9	11	1	0	1 sallë - 26 vënde 300 tituj librash + 114 tituj të rinj +QUESTIA

#### **4. Financimi**

- Financimi i veprimtarive shkencore dhe kualifikimeve të stafit,
- Financimi i veprimtarive të studentëve.

Në Albanian University, burimet financiare përgjithësisht lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. 17% e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohen për qiranë e objekteve dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja, etj), dhe 59% e burimeve të të ardhurave shpenzohen për pagat dhe sigurimet e stafit të punësuar (akademik dhe administrative), si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Konkretisht në këtë vit akademik nuk ka pasur financim të drejtpërdrejtë për trajnimin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, por është bërë i mundur lehtësimi i shpenzimeve ekonomike duke iu dhënë mundësinë për:

- Pjesëmarrjen pa pagesë në Konferenca Shkencore të organizuara nga Universiteti
- Botimin e artikujve të plotë në Revistën ‘OPTIME’ pa detyrime financiare.

Universiteti ka si qëllim që në vitet akademike në vazhdim t’i kushtojë një vëmendje të veçantë financimit të veprimtarive shkencore të pedagogëve dhe iniciativave të ndryshme të studentëve, në mënyrë të veçantë financimit dhe kualifikimit të stafit akademik brenda dhe jashtë vendit, në sajë të bashkëpunimeve që Universiteti ka tashmë prej disa vitesh me Universitetet partnere të huaja.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

## 5. Mësimdhënia

- Zbatimi i kalendarit akademik, mbështetur në relacionet e pedagogëve për lëndën e tyre.
- Sigurimi i leksioneve dhe i teksteve universitare në hardcopy dhe në rrugë elektronike, etj.

Në vitin akademik 2015-2016, kalendarit akademik është realizuar në parametra të kënaqshëm në të gjitha programet e studimit të cilat kanë qenë aktive.

Arsyeja e mos realizimit të kalendarit akademik në masën 100% në disa lëndë lidhet me:

- a. Pushimet zyrtare, të përqendruara kryesisht ditëve të javës, si e hënë dhe e martë;
- b. Pjesëmarrjen e stafit pedagogjik në Konferenca të ndryshme Kombëtare e Ndërkombëtare.
- c. Raste të rralla të mungesave të stafit akademik për arsye personale e shëndetësore.

Përgjithësisht, për të gjitha lëndët mësimore ka literaturë bazë, me përjashtim të disa lëndëve specifike që zhvillohen në nivel masteri. Studenti pajiset me literaturën bazë dhe njëkohësisht merr edhe materiale shtesë në formë elektronike nga pedagogu i lëndës. Për lëndët, ku literatura bazë mungon, studenti pajiset me leksione të përgatitura nga vetë pedagogu, të cilat i tërheq në fotokopjen e shkollës dhe njëkohësisht në rrugë elektronike. Një kopje e leksioneve depozitohet edhe në Departament.

Në të ardhmen, AU synon pajisjen me tekste bazë për të gjitha lëndët. Pedagogët janë duke punuar në botimin e ciklit të tyre të leksioneve.

Nga një vëzhgim i vazhdueshëm dhe pyetësorët e bërë me studentët del se stafi përdor metoda mësimore interaktive; ajo çka vërehet që në momentet e para të leksioneve apo seminareve është përgatitja e mirë dhe e kujdesshme e pedagogëve; përshtatja e shkencave të ndryshme me kulturën e popullatës sonë. Pedagogët trajtojnë probleme arsimore dhe edukative që lidhen me jetën tonë duke ilustruar leksionet e tyre me problematikat tona nga tekstet e ndryshme që përdorin në përgatitjen mësimdhënëse dhe detyrat mësimore.

“Albanian University” nëpërmjet ZSBC ka përdorur metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e çdo programi studimit, si:

- kontroll të vazhdueshëm ndaj studentëve gjatë të gjithë periudhës semestrale,



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

- vlerësim të performancës së pedagogëve dhe të gjithë stafit pedagogjik,
- dokumentim të detajuar të realizimit të planit mësimor për çdo lëndë dhe për çdo pedagog,
- nxjerrje të statistikave të kalueshmërisë dhe të nivelit të studentëve
- kontroll të vazhdueshëm ndaj cilësisë së programit dhe inovacioneve që sjellin pedagogët për çdo lëndë

Vlerësimi ka përfshirë temat, esetë, praktikën profesionale pranë subjekteve publike apo private, punën në grup, punën e pavarur të studentëve, duke iu përmbajtur kriterit etik dhe duke krijuar hapësira për vetëvlerësim të brendshëm. Gjatë semestrit janë zhvilluar lloje vlerësimi të ndryshme si: diskutime, prezantime elektronike, punë në grupe, analiza individuale rreth një çështjeje arsimore, etj. Pësha më e madhe në programet e studimit i ka takuar punimeve të përgatitura nga studentët duke i kushtuar mjaft rëndësi kërkimit shkencor nga burime të ndryshme dhe jo thjesht riprodhimit të leksioneve dhe teksteve shkollore.

Vlerësimi i çdo detyre është parë të realizohet në përputhje me shkallën e vështirësisë që paraqet. Por jo gjithnjë ZSBC sheh se vlerësimi është i qartë për studentët të cilat kërkojnë më shumë argumente të dhëna me shkrim në korrigjimet e pedagogëve.

Nëpërmjet vlerësimit të detyrave të parashikuara në lëndë dhe module është shqyrtuar përvetësimi i lëndës dhe studentët janë vlerësuar me pikë. Për elementet mësimore paraprakë janë planifikuar 40 pikë të mundshme. Ndërsa për provimin përfundimtar të lëndës janë planifikuar deri në 60 pikë. Për detyrat e kursit janë planifikuar nga 10 deri në 20 pikë të mundshme dhe aktivizimi në seminare, laboratorë etj. është planifikuar të vlerësohet deri në 10 pikë. Vlerësimet me pikë janë konvertuar në nota, sipas një përshkallëzimi që ka përcaktuar institucioni dhe që pasqyrohet në çdo syllabus. Në formën e kontrollit me shkrim, provimet të gjitha shihet të jenë sekretuar . Në përfundim të programit studentëve iu është njehsuar nota mesatare e ponderuar dhe iu është komunikuar me rrugë elektronike dhe të personalizuar.

Në këtë mënyrë, “Albanian University”, për kryerjen e vlerësimit dhe verifikimin e cilësisë, paraprakisht ka përdorur edhe këtë vit metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Metoda të tërthorta:

- a. Sondazhe të studentëve për të gjitha aspektet e programeve të studimit.
- b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;

Metoda të drejtpërdrejta:





**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

- a. Dëgjime në auditor;
- b. Vlerësimi me nota/pikë në detyrat gjatë semestrit;
- c. Testime paraprake dhe përfundimtare; demonstrime për module, praktikë në qendra arsimore e institucione;
- d. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, prezantimet elektronike, punën në grup, referatet);
- e. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;

Mësimdhënia pohohet se është e një niveli shumë të mirë. Nga kontaktet me studentët, doli se pedagogët përpiqeshin të ishin sa më pranë tyre, duke ndihmuar me punë individuale studentët me vështirësi në të kuptuar apo realizimin e detyrave të dhëna. Matja e cilësisë bëhej herë pas here nga shefi i departamentit që merrte pjesë në orë mësimore të veçanta ose nga interpretimi i të dhënave që dilnin prej provimeve të zhvilluara në mes të vitit apo detyrat e dorëzuara në lëndë të ndryshme.

## **6. Studentët**

- Kalueshmëria dhe nota mesatare e rezultateve të tyre për çdo program studimi,
- Problematika të lidhura me transferimet, me vërejtjet që kanë për jetën universitare, veprimtaritë ekstrakurrikulare, etj.

Cilësia në hyrje e studentëve është e ndryshme, në varësi të shkollës që kanë kryer dhe të përparimit personal të tyre.

Numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite pothuajse nuk ka luhatje të mëdha. Por ka shumë raste që studentët kalojnë në vitet pasardhëse me lëndë të pashlyera. Rregullorja lejon vazhdimin e studimeve në kursin pasardhës kur studenti ka fituar nota kaluese në lëndë mësimore me mbi 30 kredite në një vit akademik.

### **Regjistrimet dhe kalueshmëria**

Tabela 4



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

<b>Viti 2015-2016</b>	
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b>	<b>2040 studentë</b>
<b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</b>	<b>1790 studentë</b>
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>	<b>2685 studentë</b>




Tabela 5

**Viti akademik 2015-2016**

<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b>		
<b>Msc Stomatologji</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	90%	6.3
Viti II	94%	7.46
Viti III	95%	6.97
Viti IV	86%	6.6
Viti V	94%	7
<b>Msc Farmaci</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	90%	7.44
Viti II	95%	6.32
Viti III	85%	5.81
Viti IV	92%	6.8
Viti V	94%	6.5



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

<b>Bsc Infermieri</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	96%	6.5
Viti II	95%	6.6
Viti III	94%	6.8
<b>Bsc Fizioterapi</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	90%	6.59
Viti II	94%	6.85
Viti III	88%	7.1
<b>MP Infermieri Kirurgjikale</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	94%	7.59
<b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</b>		
<b>Bsc. Financë- Bankë</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	60%	5.882
Viti II	93%	6.25
Viti III	97%	6.4
<b>Bsc. Menaxhim Biznesi</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	66.00%	6.02
Viti II	80%	6
Viti III	84%	7.14
<b>Msc Menaxhim bankar</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	68%	6.88
Viti II	79%	6.96
<b>Msc Administrim biznesi</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	92%	7.2
Viti II		
<b>MP Menaxhim bankar dhe financiar</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	93%	7.39
Viti II	85%	7.10
<b>MP Administrim biznesi</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	71%	6.9
Viti II		
<b>Bsc Dizajn</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	78.7%	7.75
Viti II	79%	7.92



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

Viti III	67%	8.4
<b>Msc Arkitekture</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I		
Viti II	50%	6.97
Viti III	40%	7.39
Viti IV	31%	8
Viti V		6.9
<b>Bsc Inxhinieri Elektronike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	47%	5,46
Viti II	46%	5,65
Viti III	70%	6,47
<b>Bsc. Inxhinieri Kompjuterike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	61%	5.29
Viti II	31%	4.97
Viti III	56%	6.42
<b>Bsc Teknologji Informacioni</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	50%	5,00
Viti II	42%	5,26
Viti III	69%	6,8
<b>Bsc Inxhinieri Mekatronike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	61%	4.95
Viti II	49%	4.94
Viti III	76%	6.09
<b>Bsc Inxhinieri Elektrike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	58%	5.07
Viti II	52%	5.117
Viti III	78%	5.98
<b>Msc.Teknologji Informacioni</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	93%	6.99
Viti II	99%	7.49
<b>Msc. Inxhinieri Elektronike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	85%	6.94
Viti II	95%	6.91
<b>Msc. Inxhinieri Mekatronike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	84%	5.79



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

<b>Msc. Inxhinieri Kompjuterike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	88%	6.26
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>		
<b>Bsc. Psikologji e Përgjithshme</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	87%	6.65
Viti II	86%	6.8
Viti III	96%	7.65
<b>Bsc. Shkenca Politiko-administrative</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	70%	6.2
Viti II	85%	6
Viti III	81%	6.64
<b>Bsc. Mësuesi për arsimin fillor</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	89%	7.3
Viti III	91%	8.27
<b>Bsc. Mësuesi për arsimin parashkollor</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	94%	7.7
Viti III	100%	8.08
<b>Bsc. Shkenca Juridike</b>	<b>Kalueshmëria</b>	<b>Nota Mesatare</b>
Viti I	80%	6.8
Viti II	67%	6
Viti III	79%	6.6

Në fillim të çdo viti akademik, një pjesë e studentëve që vendosin të vazhdojnë studimet pranë “Albanian University” janë edhe ata që transferojnë studimet nga një universitet tjetër publik ose privat.

Bazuar në Rregulloren e transferimeve të “Albanian University”, fillimisht studenti i interesuar depoziton dosjen me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Kjo dosje vlerësohet nga komisioni i ekuivalentimit dhe transferimeve, i ngritur në çdo fakultet.

Në përfundim të shqyrtimit të dosjes, merret një vendim nga komisioni i ekuivalentimeve dhe transferimeve. Vendimi i bëhet i ditur studentit i cili më pas vendos nëse do të transferojë studimet ose jo.

Në vitin akademik 2015 – 2016, kanë transferuar studimet e tyre pranë “Albanian University” në total 418 studentë.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

Raporti numerik: personel akademik i brendshëm, i jashtëm/student për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë ka qenë **1:12**. duke përmbushur kështu më së miri standardet e kërkuara për të siguruar arsimim cilësor dhe objektivat e programit të studimit.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë ka zhvilluar mbi 70% të orëve të mësimit të programeve të studimeve.

“Albanian University” ka si strukturë të veçantë qendrat që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe që ofron shërbimin e këshillimit. Qendra e Karrierës ka mbështetur në mënyrë aktive studentët në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Mes studentëve që kanë ndjekur edhe këtë vit akademik programet e studimit, ka pasur mjaft prej tyre që punojnë me kohë të plotë.

Për plotësimin e këtij standardi, institucioni ka ofruar module të veçanta me karakter të mirëfilltë profesional, që kanë dhënë njohuri nga fushat ekonomiko-shoqërore, njohuri për sipërmarrjen dhe ka organizuar praktika profesionale të standardizuara.

Nga bisedat e zhvilluara me studentët ndihet se ata janë mjaft të kënaqur jo vetëm me cilësinë e mësimdhënies, por edhe me komunikimin formal dhe informal me stafin pedagogjik. Sipas pohimit të tyre, programet e studimit po i përgatisin ata për të qenë të aftë dhe të suksesshëm në tregun e punës në të ardhmen, por edhe për të kapërcyer problemet personale me të cilat ata ndeshen gjatë jetës së përditshme.

Kërkesat e të gjitha kurseve ndaj studentëve janë të njëjta. Ata duhet të ndjekin leksionet dhe të marrin pjesë në të gjitha orët mësimore, në mënyrë të detyruar. Një mungesë e pajustificuar mund të ndikojë në uljen e pikëve të ndjekjes dhe të pjesëmarrjes.

Një rol të rëndësishëm në formimin e studentit, përpos cilësisë së mësimdhënies luajnë edhe veprimtaritë ekstrakurrikulare. Kështu, gjatë vitit akademik 2015 – 2016 Departamentet e Albanian University kanë organizuar një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare. Më poshtë, gjeni një listë të tyre:

- Konferenca studentore me temë *“Të reja Inovatore në Fushën e Mjekësisë”*;
- Konferencë studentore: *“Planifikimi dhe Menaxhimi Mjedisor”*;
- Konferenca e pestë studentore me temë *“Sfidat e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë në funksion të integrimit në Bashkimin Evropian”*;
- Konferenca studentore me temë: *“Sfidat e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë në Funksion të Integrimit në BE”*;
- Konferenca Studentore me temë: *“Ligjshmëria-Konceptimi dhe zbatimi në Marrëdhëniet Shoqërore”*;



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

- Leksion i hapur me temë “Gjykata e Krimeve të Rënda dhe perspektiva e saj në kuadër të reformës në drejtësi”;
- Leksion i hapur me temë “Organizimi dhe Funksonimi i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”;
- Leksion i hapur "Is tollerance, The reason of saving jews in Albania during the II World War";
- Leksion i Hapur "Zhvillimet e fundit ne Bashkimin Evropian";
- Leksion i hapur "Te drejtat e grave deputete”;
- Leksion i hapur "Evoluimi i politikës Shqiptare në 20 vitet e fundit";
- Simpozium shkencor me temë “Dhuna, pasojat psikologjike të saj dhe parandalimi”;
- Simpozium shkencor me temë: ”Roli i psikologut në gjykatë”
- Leksion i hapur: “Suksesi ekonomik i Polonisë gjatë 25 viteve të fundit”;
- Workshop: “Pabarazia në mundësi dhe pabarazia në të ardhura”;
- Simpozium: “Të menaxhosh nëpërmjet projekteve”;
- Leksion i hapur: “Politikat konjunkturore dhe/apo strukturore: Rasti i Shqipërisë”;
- Konferencë studentore: “Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorët”;
- Workshop mbi Implantet “B&B” Dental;
- Workshop “Corso teorico-pratico di chirurgia implantare su paziente”;
- Leksion i hapur me temë: “Tekarterapia në fizioterapi”.

## **7. Kërkimi shkencor**

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga pedagogët dhe studentët, konferenca, projekte, publikime, etj.

Në fillim të çdo viti akademik, secili departament harton planin e punës së tij kërkimore shkencore në përputhje me strategjinë për zhvillimin e kërkimit shkencor në “Albanian University”. Plani vjetor i punës kërkimore në departamente për vitin akademik 2015 - 2016 është ngritur mbi këto drejtime:

- a. Aktivitete shkencore (tryeza pune, simpoziume dhe konferenca);
- b. Punime shkencore në nivel individual nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm në botime kombëtare dhe ndërkombëtare;
- c. Pjesëmarrje aktive në publikimet e revistës shkencore të universitetit tonë “Optime”;
- d. Botimi i titujve, të cilat plotësojnë ose krijojnë bazën e nevojshme të literaturës në të gjitha lëndët e drejtimit;



ALBANIAN UNIVERSITY  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

e. Kualifikim i vazhdueshëm i stafit akademik.

Kërkimi shkencor është një element i ngarkesës së pedagogëve në “Albanian University”. Tregues të veprimtarisë kërkimore janë konferencat shkencore, botimet në revista, kërkimet në bashkëpunim me institute apo agjenci kërkimore brenda dhe jashtë vendit, udhëheqjet e doktoraturave brenda dhe jashtë universitetit, etj. Udhëheqjet e punimeve të studentëve të programeve Bachelor dhe Master kanë qenë pjesë thelbësore e cilësisë së stafit pedagogjik kërkimor.

Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. AU publikon revistën periodike “OPTIME” e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU. Kërkohej një përmirësim i raporteve të autorëve që vijnë nga fusha dhe programe të ndryshme studimi. Shihet një epërsi e shkrimeve me natyrë mjekësore dhe psikologjike, dhe më pak nga shkencat e aplikuara dhe ekonomia.

Nga një këqyrje e dokumentacionit del se institucioni ka marrëveshje me disa OJF të cilat bashkëpunojnë me programe të ndryshme të studimeve duke transmetuar rezultatet e kërkimeve në veprimtari kërkimore, por edhe duke i kontribuar mësimdhënies. Në kuadër të programeve të ndryshme të studimit janë kryer edhe disa veprimtari kërkimore të realizuara nga studentët.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Albanian University për këtë vit akademik është përqendruar, kryesisht:

- në realizimin e kërkimit shkencor e të aplikuar
- në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e ti;
- në integrimin e kërkimit shkencor në mësim;
- në krijimin e një raporti të drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor;
- në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore në studentët, duke i aktivizuar ata me sprovë (ese, tema diplomash dhe mikroteza për kualifikimin e shkallës së dytë) deri edhe në përfshirjen e tyre në grupet studimore projekte që kanë departamentet ose universiteti. Sipas nenit 71/pika 3 të ligjit të sipërpërmendur, “Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen gjithashtu planifikimit”.





ALBANIAN UNIVERSITY  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

Universiteti ka 3 fakultete ku bëjnë pjesë 10 departamente, një klinikë universitare dhe Qendra koordinuese e kërkimit shkencor. Departamenti duke qenë njësi bazë mësimore kërkimore grupon brenda tij disiplina mësimore respektive, por edhe projektet shkencore.

Grupet e hulumtimit kanë përfshirë në vetvete disa ose të gjithë anëtarët e stafit akademik të departamentit, por edhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Departamentet sheh se kanë nxitur, koordinuar dhe administruar procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore shkencore duke respektuar lirinë akademike, pavarësinë grupore apo individuale të punës, si dhe administrimin e burimeve materiale dhe financiare.

Departamentet kanë qenë përgjegjës për llojet e ndryshme të veprimtarive që janë zhvilluar brenda tyre: konferenca shkencore, studime dhe kërkime, projekte, botime, etj duke i prezantuar dhe duke i bërë transparente. Duhet pohuar se procesi kërkimor është ende në hapat e parë të zhvillimit. Megjithatë, struktura dhe filozofia e institucionit promovon kulturën e kërkimit shkencor në vazhdimësi duke e vlerësuar si një element themelor të universitetit të mileniumit të ri.

Universiteti i ka mirëpritur propozimet për kërkime shkencore dhe ka vendosur për ecurinë e tyre pas diskutimeve në departamentet përkatëse. Institucioni shpesh ka kërkuar edhe bashkëpunimin e partnerëve të tjerë që mund të jenë institucione të tjera private apo publike, sidomos në fushën e mjekësisë dhe të mësimdhënies. Kultura e praktikuar në institucion shihet të ketë qenë pozitive dhe e karakterit të hapur me aktorë të tjerë të kërkimit shkencor.

“Albanian University” ka të përcaktuara prioritetet e veta për vitin akademik 2016-2017. “AU” ka një program konkret që lidhet me prioritetet kërkimore.

Gjithnjë e më shumë po lind nevoja e bashkëpunimit të ardhshëm me studiues të huaj duke pretenduar si zgjerimin, ashtu dhe thellimin e kërkimit shkencor rajonal dhe ndërkombëtar.

Institucioni ka inkurajuar stafin e vet akademik të marrë pjesë në projekte kërkimore me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

Vetë universiteti ka në praktikën e tij ftesën e lektorëve të huaj për lëndë dhe module të ndryshme. “Albanian University” edhe gjatë këtij viti ka ruajtur një inventar të pasur konferencash dhe simpoziumesh shkencore. Institucioni dhe departamentet e tij në planifikimet e bëra flasin për një promovim të rëndësishëm të punës kërkimore shkencore, të shprehur mes projektsh dhe botimesh të ndryshme.

Rezultatet e studimeve dhe kërkimeve janë bërë të njohura edhe në publikimet e revistës “OPTIME”. Shtëpia botuese “AU” Press është bërë një prej promovuesve më të mira të



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME*

veprimtarisë shkencore të stafit pedagogjik të institucionit. Të gjitha aktivitetet, botimet e librave dhe monografive të Albanian University promovohen në Panairot e librave që zhvillohen çdo vit në Shqipëri, ku në ditë të veçanta stafet akademike kanë bërë prezantimet mbi punën dhe botimet e realizuara për këtë vit akademik.

### **8. Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit**

- Marrëveshjet e firmosura me partner të ndryshëm si për praktikant profesional, ashtu edhe për shkëmbim eksperiencash.

Albanian University ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, por edhe me organizata dhe kompani biznesi për sigurimin e një procesi mësimor të standardeve evropiane. Më poshtë gjeni të listuara institucionet me të cilat është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në vitin akademik 2015-2016. Në të ardhmen synohet rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme e sidomos me universitete në rang Evrope e më gjerë, duke u vënë theksi te mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve.

Tabela 6

<b>Nr.</b>	<b>Marrëveshje Bashkëpunimi Institucionale</b>
<b>1</b>	Mediterranean and Middle East University Network Agreement (MUNA)
<b>2</b>	Mbretëresha Geraldine (Qendra e Diagnostikës Molekulare)
<b>3</b>	Iliria College, Institution of Higher Education
<b>4</b>	Urdhri i Farmacistit të Shqipërisë
<b>5</b>	Studio IRS, Financë Auditim
<b>6</b>	Capital Invest sh.a
<b>7</b>	ANAS sh.p.k
<b>8</b>	Ferlut sh.a
<b>9</b>	Alba Trans sh.p.k
<b>10</b>	Tirana Auditing 2 sh.p.k
<b>11</b>	Inter B.B.K Auditing sh.p.k
<b>12</b>	NH Euroconsult sh.p.k
<b>13</b>	AK Invest sh.a
<b>14</b>	BDO Albania sh.p.k
<b>15</b>	ProCredit Bank
<b>16</b>	A.S.C.A sh.p.k



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

<b>17</b>	Mediterranean Business Center
<b>18</b>	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit AQTN
<b>19</b>	EDS Foundation
<b>20</b>	Instituti i Monumenteve të Kulturës IMK
<b>21</b>	Kolegji AAB, Kosovë
<b>22</b>	Studio Arkitekture Arkimade
<b>23</b>	Studio arkitekture H&S Projekt
<b>24</b>	University of Padova
<b>25</b>	Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Balance”
<b>26</b>	Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Kiropraktik Klub Albania”
<b>27</b>	Klinika e Fizioterapisë “Halili”
<b>28</b>	Qendra Social – Edukative “Primavera”
<b>29</b>	Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Red”
<b>30</b>	Agjencia e Shërbimit të Sportit
<b>31</b>	The International Network of Democratic Therapeutic Communities(INDTC)
<b>32</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale, Durrës

## **9. Administrata dhe stafi ndihmës**

- Roli i sekretarive mësimore dhe asistentëve në departamente,
- Dokumentacioni shkollor,
- Regjistrat dhe plotësimi i tyre sipas syllabuseve të miratuara,

Sekretaritë mësimore dhe asistentët e departamenteve kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimorë. Sekretaria mësimore përpilon regjistrat, të cilët janë specifik për çdo lëndë dhe grup. Regjistri i grupit është një dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimit nga pedagogu. Ai është dokument zyrtar gjithashtu që vërteton frekuentimin e orës së mësimit nga studenti dhe evidenton kreditet që ai ka siguruar në atë lëndë si dhe zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet gjithnjë në dokumentacionet e posaçme përgjatë vitit akademik, në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat në përfundim



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Ndarja e studentëve në grupe shënohet në regjistra me fillimin e vitit të ri akademik. Personeli administrativ së bashku me stafin akademik angazhohen në mënyrë aktive për përmbushjen e objektivave të programit të studimit duke vënë në dispozicion materiale shtesë për studentët.

## **10. Analiza SWOT**

### **a. Pika të forta**

- Albanian University është një institucion i organizuar në mënyrë të përshtatshme brenda fushave akademike që ofron;
- Institucioni ka një mjedis dhe infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit;
- Stafi akademik i angazhuar paraqet një nivel të lartë performance në procesin e mësimdhënies;
- Të gjitha programet e studimit që ofrohen në AU janë në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit institucional,
- “AU” ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi mjaft operacionale me universitete të tjera brenda dhe sidomos jashtë vendit në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit;
- Dokumentacioni dhe mekanizmat e komunikimit janë të mirëzhvilluara. Institucioni përpiqet të jetë transparent dhe i hapur si me stafin akademik, studentët e tij, ashtu dhe me publikun e gjerë;
- Struktura organizative e “AU” është në përputhje me qasjet tipike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar;
- Universiteti realizon në mënyrë të rregullt vlerësimin e performancës së punonjësve;
- Burimet financiare të institucionit paraqiten të mjaftueshme për qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në të ardhmen
- Universiteti disponon një bibliotekë të pasur me tekste si ne hard copy ashtu edhe elektronike.

### **b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):**

- Për të lehtësuar punësimin e të diplomuarve të tij jashtë vendit, institucioni duhet të punojë më shumë për zhvillimin e kurseve të gjuhës së huaj, edhe duke i ofruar ato si një aspekt të detyrueshëm mësimor;
- Mungesë aksesit në financimet e BE;
- Përfshirje e ulët e studentëve në veprimtari kërkimore – shkencore.



**ALBANIAN UNIVERSITY**  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

**c. Mundësitë:**

- “AU” tregon një angazhim të fortë për të qenë një aktor i rëndësishëm në tregun e arsimit të lartë privat; duke ofruar një standard në rritje për realizimin e programeve të tij të studimit, do të jetë në gjendje të konkurrojë me sukses në garën për cilësi;
- Me nismat e tij të deritanishme për ndërkombëtarizimin e institucionit, “AU” duke pasur edhe ciklin e tretë të studimeve të hapur, mund të fitojë terren për të arritur nivele të larta akademike dhe profesionale me stafin dhe studentët e tij.

**d. Pengesat:**

- Angazhimi më i madh i strukturave të “AU” për futjen në hapësirat e sistemit evropian do të mund të kapërcejë problematikat në lidhje me bashkëpunimin me institucione të huaja dhe projekte rajonale dhe ndërkombëtare;
- Në disa fusha specifike, si inxhinieri, farmaci, etj është pak e vështirë gjetja e personelit akademik me tituj e grada shkencore.

**Tiranë, Shtator 2016**